



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P-068
Prishtinë, më 17 qershor 2016, ora 17:00

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 17 QERSHOR 2016**

Seancën e drejtoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës dhe sipas vendimit të seancës plenare, nr. 05-V-317, datë 17. 6. 2016.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 72 deputetë dhe procedoi me rendin e ditës, si në vijim:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Republikën e Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në pajtim me vendimin e seancës plenare, nr. 05-V-317, e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentin e propozuar.

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Komisionit FunkSIONAL që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

Nënkryetarja e Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, znj. Selvije Halimi, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj, Komisioni FunkSIONAL e kishte propozuar vetëm një (1) amendament.

Kryetari e hodhi në votim amendamentin e Komisionit FunkSIONAL.

Kuvendi e miratoi amendamentin nr. 1.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentin e miratuar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----79,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri e miratoi Ligjin nr. 05/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Republikën e Kosovës.

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare në orën 17:17 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*